

Neni 5

Familja jote ka përgjegjësinë të të ndihmojë që të mësosh se si t'i ushtrosh të drejtat e tua dhe të sigurohet që ato të drejta janë të mbrojtura.

Neni 6

Ti ke të drejtë të jetosh.

Zyrat e Gjëndjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Civile

Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, NJMF;

Strukturat e Policisë së Shtetit;

Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;

Drejtoritë Rajonale të Arsimit/ Zyrat Arsimore dhe Shkollat;

Drejtoritë e Shëndetit (specialistët e shëndetit, mjeku i familjes);

Ofruesit e Shërbimeve për fëmijë, publikë dhe privatë;

Grupet teknike multidisiplinare pranë Bashkiave dhe njësive administrative

KONTAKTONI TLAS:

TLAS ofron shërbim ligjor për çështje të së drejtës civile, administrative, familjare, të punës dhe të shkeljes së të drejtave të njeriut.

04 2258442;
0692093731;
tlas@tlas.org.al

Nga e HËNA në të PREMTE
9:00 - 14:00



ADRESA E TLAS:
Bulevardi Bajram Curri,
Pallatet Agimi,
Shkalla 18, Ap.322,
Tiranë, Shqipëri
Kutia postare nr. 69

SHERBIMI LIGJOR FALAS TIRANE



www.tlas.org.al



PSE

PA IDENTITET?

Konventa për të drejtat e fëmijëve thekson:

Neni 8

Ti ke të drejtë të kesh një identitet – një regjistrim zyrtar se kush je. Askush nuk ta heq dot këtë të drejtë.

Botimi i këtij materiali është mbështetur financiarisht nga



Neni 7

Ti ke të drejtë të kesh një emër dhe ai duhet të njihet zyrtarisht nga shteti. Ti ke të drejtë të kesh një shtetësi (t'i përkasësh një shteti).



A garanton shteti në Shqipëri zgjidhje në funksion të Interesit më të Lartë të Fëmijës?

A vepron drejtësia shpejt, pa vonesa, pa cenuar interesat e të miturve?

Nëse po përse edhe sot ndeshemi me raste të fëmijëve pa identitet?

Neni 4

Shteti ka detyrimin që të drejtat e tua të mbrohen. Ai duhet ta ndihmojë familjen tënde që të mbrojë të drejtat e tua dhe të krijojë një ambient ku ti mund mund të rritesh dhe të arrish potencialin tënd.

Shembull: B është shtetase shqiptare, emigroi në shtetin Grek, dhe lindi tre fëmijë edhe pse në moshë mjaft të re. B i dha fund marrëdhënies me bashkëjetuesin dhe u kthye në Shqipëri bashkë me tre fëmijët. Babai i fëmijëve nuk tregoi asnjëherë interes për ta. B nuk mund të regjistronte tre fëmijët e saj në zyrën e Gjendjes Civile në Fier, sepse ajo nuk kishte sjelle nga Greqia dokumenta për asnjë nga fëmijet. Këta fëmijë të paregjistruar në zyrën e gjendjes civile, janë të panjohur përpara ligjit, për ta nuk ka as gjurme të dokumentuar për lindjen apo vdekjen, ata thjesht konsiderohen sikur nuk ekzistojnë.

Dihet që gra të varfra shqiptare, nga komuniteti Rom dhe jo vetem, që jetojnë si emigrante në Greqi, i lindin fëmijët në spitalet Greke, nuk kanë mundësi të paguajnë tarifatat spitalore, largohen nga maternitetet në mënyrë të fshehtë dhe pa u pajisur me dokumentacionin e nevojshëm të lindjes, pa të cilin nuk mund të fillojnë procedurat e regjistrimit në zyrën e gjendjes civile përkatëse. Po ashtu dihet që fëmijët e paregjistruar janë më vulnerabël dhe të ekspozuar

Neni 3

Çdo i rritur duhet të bëjë atë që është më e mira për ty. Kur të rriturit marrin vendime, ata duhet duhet të mendojnë se si vendimet e tyre do të ndikojnë tek fëmijët.

zuar ndaj dhunës në familje, bëhen viktime të trafikimit, punës së detyruar dhe shume formave të tjera të abuzimit. Raste si ky dhe jo vetëm bëjnë që në Shqipëri të këtë ende qindra fëmijë të paregjistruar domethënë të padukshëm e pa shtetësi.

Kush përgjigjet për fëmijët e paregjistruar?

Po kush janë strukturat që bien në kontakt me fëmijët pa identitet ose të e paregjistruar në zyrat e gjendjes civile?

Kush duhet të identifikojë, evidentojë e referojë rastet e fëmijëve të paregjistruar?